[Shqiptarja.com]
E enjte 17 Dhjetor 2020 - Përditësimi i fundit 20:48

Kërko
● Të gjitha fjalët ○ Të paktën një fjalë ○ Fjalët ekzakt

LIVE [Shqiptarja.tv]

SHËNDETI DREJT PUNËS LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL TIRANA RECETA HOROSKOPI MOTI DOSSIER FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

HOME FAQJA JUAJ AKTUALITET POLITIKË EKONOMI SOCIALE SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË ANALIZË

VRASJA MAKABRE E ÇIFTIT PASHO NË ITALI

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

FOTO dhe VIDEO/ Jeta luksoze e Taulant Pashos pas zhdukjes së prindërve, të cilët shkuan në Itali për ta pritur në derën e burgut dhe më pas u gjetën të masakruar

2

Vrasja e çiftit Pasho në Itali, mediat italiane: Misteri i 40 mijë eurove të zhdukura

3

Djali i çiftit shqiptar të vrarë në Itali/ Autoritetet italiane zbulojnë ku ndodhet Taulant Pasho: Në burg në Zvicër prej 2 muajsh

4

Për dy jeniçerët e rinj, Kur(d)i dhe Osmani

5

Shkoi i plagosur në market/ Flet pronari: Erdhi me shpejtësi u ul në një stol! Fjalia e vetme që më tha dhe pastaj i ra të fikët (VIDEO)

Aktualitet

Ekzekutimet seriale/ Vritet në Rrëshen kushëriri i vëllezërve Armando dhe Preng Gjini! Keli u qëllua sapo zbriti nga makina, eci në këmbë deri në market por ndërroi jetë në spital

Vijon saga e hakmarrjeve në Rrëshen! Vritet në Rrëshen 51 vjeçari Anton Keli, kushëriri i Armando (Tonin) Gjinit dhe i Preng Gjinit. Anton Keli është plagosur sot në rrugë rreth orës 17:40, dhe më pas është transportuar në spital aty ku dhe ka ndërruar jetë si pasojë e plagëve të marra. Dyshohet se autorët po e ruanin dhe 51 vjeçari është qëlluar duke zbritur nga pallati ku jetonte

- Policia blindon Rrëshenin, ngre postblloqe në disa pika! Disa të shoqëruar
- Në Rrëshen kishte vetëm nënën, familjarët e tjerë i jetojnë në Gjermani
- Autorët e kanë ruajtur Anton Kelin
- Historia e ekzekutimeve seriale në Rrëshen që solli vrasjen e Anton Kelit

Redaksia
15 Dhjetor, 18:28 | Përditesimi i fundit: 15 Dhjetor, 22:29

Vijon saga e hakmarrjeve në Rrëshen! Vritet 51 vjeçari Anton Keli, kushëriri i Armando (Tonin) Gjinit dhe i Preng Gjinit.

Anton Keli është plagosur sot rreth orës 17:40, dhe më pas është transportuar në spital aty ku dhe ka ndërruar jetë si pasojë e plagëve të marra. Dyshohet se autorët po e ruanin dhe 51 vjeçari është qëlluar duke zbritur nga makina. Pasi është qëlluar ka lëvizur në këmbë për disa metra dhe ka hyrë në një market, ku ka treguar se e kanë plagosur. Ka qenë shitësja ajo që ka lajmëruar policinë dhe

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

MINUTË PAS MINUTE

20:48

FIFA zgjedh Robert Lewandowski lojtarin më të mirë në botë për 2020, lë pas Messin dhe Ronaldon

20:19

U shkarkua nga Vettingu, Besnik Muçi padi në Gjykatën Administrative! Kërkon shkarkimin e anëtarëve të KPA dhe KPK

20:17

ANALIZA - *Mero Baze*
Për dy jeniçerët e rinj, Kur(d)i dhe Osmani

20:10

Aksident në Vlorë/ Makina përplaset me hekurat pranë tunelit, shoferi dërgohet me urgjencë në spital

19:57

Tragjedi në një familje shqiptare në Gjermani! Burri vret gruan, vajzën dhe më pas var veten

ambulancën. Menjëherë u dërgua në spital, por aty ka ndërruar jetë.

LEXO EDHE:
Konflikte për pronat në Lezhë, fqinji plagos me 2 plumba në këmbë Hilë Gjinin teksa dërgonte fëmijët në shkollë! Autori i arrestuar: Në 2004 më helmoi delet (VIDEO)

Nga tërësia e veprimeve hetimore rezulton se 51-vjeçari është qëlluar me pistoletë nga një distancë e afërt dhe një nga plumbat e ka prekur në pjesën e gjoksit. Sipas burimeve Keli jetonte vetëm me nënën në Rrëshen, ndërsa të gjithë familjarët e tjerë ishin në Gjermani. Lidhur me vrasjen e tij janë shoqëruar në komisariat disa persona dhe po merren në pyetje për zbardhjen e ngjarjes. Ndërkaq policia ka blinduar zonën duke ngritur disa pika kontrolli, për të kapur autorët të cilët nuk janë identifikuar ende.

Keli është kushëriri i Armando (Tonin) Gjinit dhe i Preng Gjinit. Armando Gjini mbeti i vrarë në 12 ngusht 2019. ***Armando Gjini***, i kishte shpëtuar më parë dhe një atentati me tritol, pasi fatmirësisht ka mundur ta pikasë në kohë lëndën eksplozive. Ndërkohë një vit pas vrasjes së Armando Gjinit, në Tiranë organizohet një atentat akoma dhe më i sofistikuar ndaj vëllait të tij, Preng Gjini.

Gjinit i është bërë atentat më 15 shtator në Tiranë. Por ai fatmirësisht i ka shpëtuar atentatit të mirëorganizuar mbi urën e Selitës dhe më pas iu nënshtrua një operacioni në bark, duke kaluar gjendjen kritke. Makinës së tij i vendosën tritol të një sasie 400 gram C4 në pjesën e përparme të makinës dhe shpërthimi i madh është kontrolluar nga një telekomandë në distancë ndërsa ai ishte duke udhëtuar. Vrasja e Kelit dyshohet se lidhet me sagën e hakmarrjeve mes ***dy fiseve Gjini dhe Reçi në Rrëshen.***

"*Rreth orës 17:40, në qytet Rrëshen, Mirditë, në rrugë është plagosur me armë zjarri shtetasi A.K., 51 vjeç, banues në fshatin Malaj, Mirditë, i cili është transportuar në spital dhe ndodhet nën kujdesin mjekësor. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e Policisë dhe Grupi hetimor dhe vijon puna për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes. Shërbimet e Policisë të D.V.P. Lezhë, të Komisariatit të Policisë Mirditë dhe FNSH-së po krehin zonën si dhe janë ngritur pika kontrolli me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve*", thuhet në njoftimin e policisë.



Armando Gjini, Anton Keli dhe Preng Gjini

[Shqiptarja.com]

MOTI Shqiperi

Qytetet	Enjte	Premte	Shtunë
Tirana	15.51°C	13.97°C	14.02°C
Korce	9.73°C	11.07°C	9.33°C
Shkoder	13.63°C	13.73°C	13.44°C
Gjirokaster	14.93°C	13.99°C	13.94°C

Me te lexuarat e dites Me te lexuarat e javes

Lajme Fotogaleri Videogaleri

1. FOTO dhe VIDEO/ Jeta luksoze e Taulant Pashos pas zhdukjes së prindërve, të cilët shkuan në Itali për ta pritur në derën e burgut dhe më pas u gjetën të masakruar
2. Vrasja e masakrimi i çiftit Pasho/ Vajza për 'Pa Gjurmë': Banorët denoncuan se në garazhin e vëllait mbante erë të rëndë! Nusja, personi i fundit që i pa
3. Kuçovë/ Konflikti për stallën e derrave, qiraxhiu vret pronarin me 2 karikatorë kallashnikovi! Prej më shumë se 1 viti nuk i jepte pagesën
4. Vrasja e çiftit Pasho në Itali, mediat italiane: Misteri i 40 mijë eurove të zhdukura
5. Rastësi me datat? Ditën që djali lirohet nga burgu për drogë, zhduket çifti Pasho! Taulant Pasho prej 2 muajsh në burg në Zvicër
6. Zbardhet ekspertiza/ Klodjan Rasha ka vetëm një plumb në brinjë nga ana e djathtë që ndaloi në zemër! Dëmtimet në kokë janë bërë nga mjekët
7. Vrasja e Klodjan Rashës/Arma e gjetur, pistoletë 'Zoraki', testi i ADN-së do përcaktojë kujt i përket! Ekspertiza: Viktima ka vetëm 1 plumb në brinjë, dëmtimet në kokë u bënë nga mjekët
8. U dëmtua në sy gjatë protestave për Klodjan Rashën/ Përfundon me sukses operacioni në Turqi për policin
9. Ç'është ky emër? Ledri dhe Sara e pagëzuan kështu vajzën e tyre, por çfarë kuptimi ka?
10. Ikin kinezët, grupi Kastrati në negociata për të blerë koncesionin e Aeroportit të Rinasit

[Shqiptarja.com]

Anton Keli

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 21:13

Vrasja e kushëririt të Armando e Preng Gjinit/ Policia blindon Rrëshenin, ngre postblloqe në disa pika! Disa të shoqëruar

Andon Keli kushëriri i Armando e Preng Gjinit është vrarë sot në Rrëshen dhe pas kësaj ngjarje policia ka blinduar zonën.

Janë ngitur postblloqe në disa pika dhe po kryehen kontrolle. Në terren nga policia janë nxjerrë dhe autoblinda.

Autorët e vrasjes së Kelit nuk janë indentifikuar ende por policia ka shoqëruar në polici disa persona të cilët po merren në pyetje për zbardhjen e plotë të saj.

Ora 20:07

Atentati ndaj Kelit/ Pasi u qëllua ka lëvizur në këmbë për disa minuta! Hyri në market dhe kërkoi ndihmë! Në Rëshen kishte vetëm nënën, familjarët e tjerë në Gjermani

Detaje të reja nga atentati që i është bërë në Rrëshen, Anton Kelit.

Sipas burimeve Keli jetonte vetëm me nënën në Rrëshen, ndërsa të gjithë familjarët e tjerë ishin në Gjermani. Dyshohet se është qelluar me pistoletë. Kur është qëlluar ka lëvizur në këmbë për disa metra dhe ka hyrë në një market ku ka thënë se e kanë plagosur, dukekërkuar ndihmë Ka qenë shitësja ajo që ka lajmëruar policinë.Më pas është dërguar në spital por aty ka ndërruar jetë.

Ora 19:59

Vrasja e Anton Kelit në Rrëshen, dalin pamje nga vendi i ngjarjes

Këto janë pamjet nga vendi i ngjarjes ky është vrarë Anton Keli, kushëriri i Armando dhe Preng Gjinit.

Ora 19:22

Nga ish-drejtori i OSHEE te Kastriot Reçi, Armando Gjini e Preng Gjini! Historia e ekzekutimeve seriale në Rrëshen që solli vrasjen e Anton Kelit

Vrasja e 51 vjeçarit Anton Keli, kushëri i Armando Gjinit dhe Preng Gjinit, vijon sagën e vjetër të hakmarrjes në Mirditë.

SERIALI I VRASJEVE

Sajmir Jaku, drejtor i Tensionit të Lartë në OSHE për Veriun, u vra më 9 shtator 2016. Dyshohet se dy persona të armatosur kanë qëlluar për vdekje zyrtarin, ndërsa nga të shtënat me armë edhe një person tjetër mbeti i plagosur. Policia ka thënë se Sajmir Jaku është qëlluar me kallashnikov kur ka qenë duke pirë kafe në një nga lokalet e zonës më të frekuentuar të qytetit të Rrëshenit me një shok.

Pas vrasjes, autorët braktisën automjetin tip "BenzMercedes" në një fshat të Kurbinit ku e kanë djegur dhe më pas u larguan. Ngjarja mbeti e pasqaruar, edhe pse për hetimin e saj u angazhua Policia dhe Prokuroria me gjithë burimet e tyre njerëzore.

Me dhjetëra veprime hetimore u kryen për disa muaj me radhë, por përfundimisht ngjarja ka mbetur pa autorë. I vetmi fakt që dihet është se autorët e atentatit kanë qenë dy persona.

VRASJA NË ITALI

Një tjetër krim që u dyshua se kishte lidhje me këtë serial hakmarrjeje, ishte vrasja e ndodhur më 28 prill 2017 në Itali, ku u ekzekutua shtetasi **Gaspër Reç**i, i cili u qëllua me katër plumba. Policia dyshonte se vrasja e Gaspër Reçit mund të ishte kryer si hakmarrje për vrasjen e Sajmir Jakut.

Pak më vonë, më 6 shtator të po atij viti, vritet 31-vjeçari Kreshnik Gjini në komunën e Forestit të Belgjikës. Gjini ishte nipi i Sajmir Jakut dhe u dyshua se ishte vrarë në shenjë hakmarrje për ekzekutimin e Gaspër Reçit në Romë. Në lidhje me tri ngjarjet, mësohet se Sektori i Krimeve të Rënda në Policinë e Shtetit ka shkëmbyer informacione e prova me Policinë belge dhe atë italiane.

VRASJA NE BELGJIKE

Policia shqiptare u përfshi në hetimet për vrasjen e 31-vjeçarit **Kreshnik Gjin**i, i cili u ekzekutua më 6 shtator 2017 në Belgjikë. Ka qenë Policia belge ajo që ka kërkuar ndihmën e Policisë shqiptare për hetimin e ngjarjes, e cila dukej se kishte lidhje me një serial vrasjesh e hakmarrjesh të ndodhura edhe në vendin tonë.

Një vajzë e identifikuar me emrin Kristina, e cila ka qenë e dashura e Kreshnik Gjinit, ka pohuar për policët belgë se daja i 31-vjeçarit është vrarë një vit më parë në Shqipëri. Daja i tij ishte Sajmir Jaku, ish-drejtori i linjës së Tensionit të Lartë për Veriun në OSHEE.

“Ai ndihej i kërcënuar”, ka thënë e dashura e Kreshnik Gjinit në dëshminë e dhënë para hetuesve. Bazuar në historinë e 31-vjeçarit të vrarë, por edhe në dëshminë e dhënë prej së dashurës, hetuesit belgë dyshonin se vrasësit ishin shtetas shqiptarë që mund të kishin vepruar për çështje hakmarrje.

VRASJA NE RRESHEN

Më 13 gusht të vitit 2019 u ekzekutua në qendër të qytetit të Rrëshenit, në sy të dy fëmijëve, **Armando Gjin**i, i njohur edhe me emrin Tonin Gjini. Shkak për këtë ngjarje, sipas Policisë dyshohej e kaluara e tij në Belgjikë. Gjini u qëllua disa herë me pistoletë, ndërsa ndodhej brenda automjetit të tij përballë katedrales. 48- vjeçari dyshohet që të jetë vrarë për shkak të prishjes së pazareve të drogës.

Hetuesit, nga ana tjetër, nuk përjashtojnë pistën e gjakmarrjes, pasi familja e tij është përfshirë në një konflikt të përgjakshëm shumë vite më parë. Por, nisur nga mënyra e ekzekutimit, e cila i ngjan stilit mafioz, hetuesit thonë se ka pak gjasa që të bëhet fjalë për hakmarrje. Në konsideratë është marrë dhe një pistë e tretë, që ka të bëjë me dyshimet e vrasjes për shkak të borxheve.

48- vjeçari njihej si pjesë e grupit të Met Kananit. Vrasja e tij dyshohet se është bërë nga njerëz me pagesë.

Viktima, i njohur ndryshe si Tonin Gjini, ishte person i njohur në qytetin e Rrëshenit, kjo edhe për shkak të arrestimit të tij në vitin 2018 dhe vendosjes së eksplozivit në makinë pak kohë para vrasjes. Konflikti midis dy familjeve nisi në vitin 2016 për shkak të një ngarkese droge nga Turqia

Në 7 janar 2020 u ekzekutua **Kastriot Reçi**. Me vrasjen me snajper të Kastriot Reçit në hyrje të lokalit të tij numri i ezekutimeve në qytetin verior me rreth 30 mijë banorë ka shkuar në pesë brenda tre vitesh.

Në 15 shtator 2020 iu bë atentat **Preng Gjinit** në afërsi të ish-Nesharakut në Tiranë, me tritol. Gjini mrekullisht shpëtoi. Makinës së tij i vendosën tritol të një sasie 400 gram C4 në pjesën e përparme të makinës dhe shpërthimi i madh është kontrolluar nga një telekomandë në distancë ndërsa ai ishte duke udhëtuar. Shpërthimi ka qenë aq i fuqishëm saqë ka shkaktuar dëmtime edhe dy makinat përreth dhe janë plagosur dy kalimtarë, një 45-vjeçar italian i identifikuar si Silvano Barbadoni dhe 14-vjeçar.

Ora 19:09

Atentati në Rrëshen/ Anton Keli u qëllua duke dalë nga makina! Autorët e kanë ruajtur

Detaje të reja janë zbardhur nga atentati i ndodhur pak më parë në Rrëshen ku u vra Anton Keli.

Ai është qëlluar sapo ka dalë nga makina kurse autorët e kanë ruajtur.

Ora 18:56

Iu bë atentat në Rrëshen/ Del fotoja, ky është Anton Keli, kushëriri i Armando dhe Preng Gjinit

Ky ëshë Anton Keli kushëriri i Armando dhe Preng Gjinit. Atij iu bë atentat me armë pak minuta më parë në Rrëshen.

Be.K./r.k./Shqiptarja.com

TAG: plagosje me arme zjarri | rreshen | Armando Gjini | preng gjini | Anton Keli | vrasja e anton kelit

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

Sondazhi i ditës:

A është Bledi Çuçi zgjedhja e duhur për postin e Ministrit të Brendshëm?

Po | Jo | Nuk e di

Komento

Komente

Dion: 16/12/2020 09:07

Lerini hasmerite o shqiptare,,c'do humbje jete eshte humbje per gjithe shtetin dhe shoqerine shqiptare,,sepse kemi investuar ne kete njeri qysh nga lindja...

Përgjigju

Nipi: 16/12/2020 04:08

Si vritet nipi per dajen? Keto sjane as me kanun dhe as Bibel, pa din as iman, vrasin gra dhe femije! Jazek!

Përgjigju

daja: 16/12/2020 07:44

po vritet o nipçe vritet se nipi mer hak per dajen smer bota o nipçeeee

ndreca: 15/12/2020 23:40

te dy fiset kan meshtetjen e policies,fisi reci perfacsohet nga shefi antidroges qarkut klodjan shaini nersa fisi gjini nga shefi komisarjatit policies nik nikollaj.dhe nuk baet fjal me u gjet autoret e ktyne vrasjeve por noj dite do shtihen ne komisrjat te dyja kto pale kundrshtrae

Përgjigju

Ana: 15/12/2020 21:35

Kur lexon "policia blindon qytetin", thua se e gjeten autorin. Kush do e blindoje qytetin, ata policia qe rrine tape gjithe diten neper lokalet e Rreshenit, apo FNSH me janbanxhinj qe duan te ikin nje ore e me pare ne shtepi. Gjynah ai i shkreti qe iku thuaj. Me mire te rrinte dhe ky i ndjeri ne Gjermani sesa erdhi ne kete vend te mallkuar nga zoti.

Përgjigju

jetmira: 15/12/2020 23:34

ja se autorin do ta gjej tik tafciu me pantallona t verdha qe e ka mendjen gjith diten me pallu zedhensen e drejtorise

Miku: 15/12/2020 19:25

Radha e pales kundershtare

Përgjigju

Lajme të tjera

Aktualitet

Aksident në Vlorë/ Makina përplaset me hekurat pranë tunelit, shoferi dërgohet me urgjencë në spital

17 Dhjetor, 20:06

Aktualitet

Ndërpreu vettingun duke u dorëhequr, Arjana Liço mbetet 15 vite jashtë sistemit të drejtësisë

17 Dhjetor, 19:41

Aktualitet

KLP komandon prokuroren Fatjona Memçaj si ndërlidhëse me EUROJUST, do jetë në Hagë për 2.6 vite

17 Dhjetor, 18:59

Aktualitet

Pas vrasjes së Klodian Rashës/ SHÇBA nis hetimin administrativ në repartin 'Shqiponja', në 'sitë' që nga rekrutimi deri te veprimet policore

17 Dhjetor, 18:52

Aktualitet

Djali i çiftit shqiptar të vrarë në Itali/ Autoritetet italiane zbulojnë ku ndodhet Taulant Pasho: Në burg në Zvicër prej 2 muajsh

17 Dhjetor, 18:04

Aktualitet



Vrau shokun pa dashje me armë gjahu në Maqellarë, del fotoja e 18 vjeçarit

17 Dhjetor, 18:03

[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2020 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje